


**JAVA / DITA OLIMPIKE
dhe
EDUKIMI OLIMPIK
NE SHKOLLE**

**EDUKIMI OLIMPIK NE SHKOLLE NJE MODEL
PER TU ZBATUAR NE PRAKTIKE**

OLIMPIZMI

Qëllimi i Olimpizmit është që të kontribuojë në ndërtimin e një bote më të mirë duke edukuar të rinjtë nëpërmjet të ushtruarit me aktivitete sportive pa asnjë lloj forme diskriminimi dhe me shpirtin Olimpik, i cili kërkon mirëkuptim të ndërsjelltë me shpirt miqësise, solidaritetit dhe fair play.



Edukimi i të rinjëve

Ndërtimi i një bote më të mirë

Duke u nisur nga ky parim themelor i Kartës Olimpike, tashmë i provuar, na lind natyrshëm nxitja se duhet të kontribuojmë në rininë tonë Shqiptare për të transmetuar tek ata disa parime themelore që e gjithë bota, të gjithë fëmijët e botës, të gjithë sportistët, të gjithë njerëzit dëshirojnë që ti kenë dhe të udhëhiqen nga to. Parime të tilla si:

Toleranca,
bujaria,
uniteti,
miqësia,
mos diskriminimi,
respekti për të tjerët,
paqja, etj





Ku më mirë do ti gjejmë këto?

IDEALET OLIMPIKE

Ndërthurja e sportit me artin, kulturen dhe edukimin,
Olimpizmi një mënyrë jete të bazuar në:

- Harmonizim të zhvillimit mendor, trupit dhe karakterit
- Kënaqësisë që buron nga përpjekja
- Vlera edukuese e të qenit një model i mirë për të tjerët
- Vëzhgimit të vlerave universale etike të:
 - Tolerancës, bujarisë, bashkimit, miqësisë, mosdiskriminimit dhe respektit për të tjerët




Identifikohen talente

Krijon persinalitetin
dhe nderton model te mire per
shoqerine



Perpjekja zhvillon karakterin



Qëllimi i Olimpizmit

Oлимпizmi e përdor sportin për të promovuar zhvillimin harmonik të njerëzve si një hap thelbësor në ndërtimin e një shoqërie paqësore, një vlerë e dinjitetit njerëzor.

Kredoja Olimpike

Gjëja më e rëndësishme në Lojërat Olimpike nuk është të fitosh, por të marrësh pjesë, sikurse gjëja më e rëndësishme në jetë nuk është triumfi, por përpjekja.

Gjëja më thelbësore nuk është të kesh dal fitimtar por të kesh luftuar mirë



CITIUS – ALTIUS – FORTIUS



- Motoja Olimpike në latinisht është “Citius-Altius-Fortius”, që do të thotë “Më Shpejtë – Më Lartë – Më fortë”.
- Në interpretimin modern motoja shpreh qëllimin e sportistit që të vrapojë shpejtë, të kërcejë më lartë dhe të hedhë më fortë.



Si të organizosh një Ditë Olimpike në Shkollë

Para se të vijohet me mënyrën se si të organizohet Dita Olimpike në shkollë duhet të shtrojmë dy pyetje:

- 1. Pse duhet të organizohet Dita Olimpike?**
- 2. Çfarë përfiton shkolla nga Dita Olimpike?**

Pse duhet të organizohet Dita Olimpike?

- Për të përqëndruar vëmëndjen në suksesin e arritjeve personale për të gjithë nxënësit
- Për të ofruar një mundësi kulminative për integrimin e aktiviteteve kroskurrikulare
- Për të organizuar një aktivitet mbarë-shkollor, bazuar në temë Olimpike, duke theksuar bashkëpunimin, pjesëmarrjen dhe fair play.



Çfarë përfiton shkolla nga Dita Olimpike?

- Zhvillon kuptimin e idealeve Olimpike të cilat reflektojnë vlera të vlefshme sociale dhe shkollore
- Ngren lart imazhin e shkollës në komunitet
- Publicitet duke siguruar një raportim në median e shkruar ose vizive



Shkolla ka feste



Planifikimi paraprak



Grupi organizator

- Zgjedhja e datës dhe orës për festimin e Ditës Olimpike
- Zgjedhja e një koordinatori për aktivitetet e Ditës Olimpike
- Krijimi i Grupit Organizator – Duhet të përfshihet nga një mësues nga çdo lëndë
- Grupi organizator duhet të takohet shpesh dhe të raportojë mbi zhvillimet për çdo klasë. Kjo do të mbajë të gjithë shkollën të përfshirë në këtë proces
- Çdo anëtar i Grupit organizator i ngarkohet një ose disa përgjegjësi



Fushat e përgjegjësisë

- Detyrat e sugjeruara më poshtë do tju ndihmojnë për të formuar një kornizë për të hartuar Lojërat.



Struktura

- ❑ Perdor simbolet Olimpike duke imituar ne miniature nje Olimpiade (pishtari, stafeta, flaka, falmuret, pellumbat, parada)
- ❑ Krijo nje sllogan, logo apo imazh per aktivitetin
- ❑ Zgjidh një mori aktivitete për Ditën Olimpikë të tilla si:
 - ❑ Veprimtari atletikore
 - ❑ Lojëra garuese dhe jo garuese
 - ❑ Lojëra me skuadra
 - ❑ Lojëra popullore
 - ❑ Veprimtari Artistike-Kulturore
 - ❑ Ringjall vlerat tradicionale (kenge, valle, kostume)
- ❑ Sigurohu që të gjithë fëmijët të marrin pjesë. Skuadrat mund të jenë të çdo lloj forme ose grup moshe.
- ❑ Siguro një mjet për të komunikuar me pjesëmarrësit (psh. mikrofon, qëndëqr zëri)



Fusha e Koordinimit

- Përcakto vëndin dhe kush do të drejtojë secilën veprimtari.
- Planifikimi për këtë proces përfshin : pajisjet, mënyra e hyrjes, programi i aktiviteteve, zyrtarët, etj.

Ceremonitë

- ❑ Përcakto se çfarë elementësh të Ceremonisë së hapjes apo mbylljes të Ditës Olimpike dëshiron të përfshihet.
- ❑ Fto miqë të tillë si autoritetet lokale, sportistë të njohur, qeveritarë, prindër dhe median.
- ❑ Njofto radion lokale, televizionin ose gazetë



media-prinder-komunitet



ftoni njez te njohur dhe autoritete te institucioneve per ti dhene prestigj aktivitetit



Përcakto se çfarë elementësh të Ceremonisë së hapjes apo mbylljes të Ditës Olimpike dëshiron të përfshihet.

Simbolet Olimpike

Flamuri, pishtari, nderzja flakes, pellumbat, parada



Çmimet

- Përcakto kategoritë e çmimeve.
- Përcakto se si do të shpërndahen çmimet, kur dhe nga kush (*nderoni te ftuarit per te ndare cmimet*)

Autoritete lokale



Nga sportiste te njohur



Pergatitur nga Kliton Muca
Komiteti Olimpik Kombetar Shqiptar

Shërbimet mbështetëse


- Sigurohu që të ketë një vend për ndihmën e shpejtë dhe doktorin e shkollës.
- Siguro vende me hije dhe ofro pije freskuese për pjesmarrësit dhe spektatorët






Aktivitetet per cdo lëndë kurrikulare

- ❑ Art (konkurs pikturë me tematikë sportive, valle popullore ose kercime moderne)
- ❑ Edukim Fizik (lojera sportive, lojera levizore, etj)
- ❑ Gjuhë-Lexim (ese, aktrim, moderator)
- ❑ Matematikë (mbajtja e pikeve dhe rezultatet)
- ❑ Gjeografi (quiz mbi vendet ku janë organizuar LO)
- ❑ Histori (lojerat Olimpikë antike dhe moderne)
- ❑ Muzikë (himni shqiptar, Olimpik, kënga e shkolles, etj)
- ❑ Shkencë (fizikë-kimi-biologji) – biomekanika, substancat doping, funksionet fiziologjike, etj.
- ❑ Shëndet (dikutime të hapura mbi të ushqyerit të shëndetshëm)
- ❑ Aktivitete të ndryshme



ART

- Mesuesi i Vizatimit do të punojë bashkarisht me nxënësit për të krijuar këndin e artit. Nxënësit që do të marrin pjesë do të bëjnë vizatime të ndryshme me tema të ndryshme mbi Olimpizmin por edhe punime të tjera që do të jenë në funksion të dekorit të veprimtarisë.
- Temat mund të jenë nga më të larmishmet psh. Lojërat Olimpike në perceptimin e nxënësve, Paqja, Fair Play, Respekti, Miqësia, etj. të gjitha këto të para në këndvështrimin e kontributit që kanë aktivitetet sportive për të edukuar vlera të tilla
- Punimi më i mirë do të vlerësohet nga një Juri e përcaktuar më parë dhe ai punim do të qëndrojë në këndin sportiv të shkollës



Matematike

- Nxënësit duhet të ndihmojnë mësuesit që mbajnë pikët dhe të ndihmojnë në gjykimin e garave
- Një aktivitet që mund të bëhet me nxënësit është quiz mbi monedhat e vendeve të ndryshme

Gjeografi - Histori



- Krijo hartën e botës dhe përcakto shtetet dhe qytetet që kanë pritur Lojërat Olimpike. Psh: jepet viti 1972 , nxënësit duhet të gjejnë në cilin shtet janë mbajtur L.O., qyteti, në cilin kontinent ndodhet, sa banorë ka ai vend, sa banorë ka ai qytet cila është gjuha amtare, etj.
- Një aktivitet tjetër do të ishte që nxënësit të gjenin se në cilat shtete do të kalojë pishtari Olimpik për Lojërat Olimpike “Pekin 2008”. Mund të dizenjohet mbi një hartë të dhënë ose të shkruhen mbi një tabelë.
- Nxënësit do të vizatojnë dhe do të gjejnë flamurët e vendeve që përfaqësojnë, pjesëmarrëse në Lojërat Olimpike

Muzikë

- Këngë të ndryshme të ekzekutuara nga nxënës të shkollës
- Këngët mund të kenë karakter argëtues, tradicional, sportiv, etj



Pergatitur nga Kliton Muca
Komiteti Olimpik Kombetar Shqiptar



Ekzekutime te

Performime të ndryshme lidhur me sportin:

Dramë
Kërcim
Humor, etj.



Pergatitur nga Kliton Muca
Komiteti Olimpik Kombetar Shqiptar



Shkencë


Diskutim nga nxënësit mbi ndikimin që ka shkenca në sport.

Psh. Bicikletat, veshjet e notarëve, këpucët atletikore, skitë, teknologjia e informacionit, inxhinjaria, etj.



Shëndeti

- Mësuesi i Biologjisë ose i Edukatës Shoqërore mund të bëjë një bisedë e hapur me nxënësit se si duhet të jetë një mënyrë e shëndetshme të ushqyeri dhe sa i dobishëm është aktiviteti fizik për të patur një trup të fortë, të bukur dhe të shëndetshëm



Edukimi Fizik

- Këtu do të fokusohet edhe pjesa më madhe e programit.
- Do të ketë skenar të mirëpërcaktuar dhe që ndërthuret me të gjitha elementët e tjerë të aktiviteteve.
- Duhet përgatitje paraprake të aktiviteteve që do të përfshihen
- Duhet një program I rregullt
- Përshëndetja e një sportisti Olimpik



Tërheqje litari

Vlerat edukative


- Bashkëpunim
- Fair play
- Përpjekje
- Shpirt gare
- Punë në skuadër
- Shoqërizim



Vrapim shpejtësie 50m

Vlerat edukative


- Përpjekje
- Vetvleresim
- Shpirt gare
- Sukses
- Fair play
- Karakter



Stafeta

Vlerat edukative

- Pune grupi
- Strategji
- Fair play
- Karakter
- Bashkëpunim
- Miqësi
- Respekt



Lojëra skuadre

Finalet

- Mini futboll
- Volejboll
- Basketboll

Vlerat edukative

Vlerësim
Respekt i ndërsjelltë
Strategji
Fair play
Bashkëpunim
Tolerancë
Mos diskriminim
Miqësi